

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR POLICINË E BURGJEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi kryesor i projektligjit “Për policinë e burgjeve” konsiston në:

- krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar sigurinë në burgje dhe paraburgime;
- përmirësimin e gjendjes ekonomike financiare dhe të kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë;
- përmirësimin e procedurave të rekrutimit, të trajnimit dhe të promovimit në detyrë të punonjësve të Policisë së Burgjeve;
- garantimin e rotacionit të vazhduar brenda sistemit, me qëllim motivimin dhe shmangien e konsumit profesional, të stresit dhe të frustrimit të punonjësve;
- respektimin e të drejtave të punonjësve duke siguruar mbështetje edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Gjithashtu, projektligji synon zbatimin e masave të parashikuara në vendimin nr.201, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019-2021”. Në këtë plan është parashikuar që Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të vazhdojnë reformimin e sistemit të burgjeve, me qëllim garantimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë të burgjeve në përputhje me standardet e BE-së, nëpërmjet forcimit të kapacitetit të Policisë së Burgjeve.

Qëllimi i projektligjit do të përmbushet nëpërmjet përmirësimit të akteve nënligjore për sistemin e burgjeve, si edhe duke përmirësuar statusin e punonjësve, organizimin strukturor dhe organizativ të sistemit të burgjeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj propozohet në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: “Qeveria do të hartojë dhe do të zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale.”

Pikërisht, rishikimi i kriterëve hyrësë, ecuria në karrierë dhe përmirësimi i proceseve të punës së punonjësve të Policisë së Burgjeve qëndrojnë në thelb të kësaj reforme. Përmirësimi i të drejtave dhe kushteve të punësimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve do të sigurojë krijimin e një sistemi sipas standardeve evropiane për menaxhimin e sigurisë në burgje, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të stafit të policisë dhe përqasjen me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e sigurisë në burgje dhe trajtimin e stafit policor.

Ky projektligj është i parashikuar në programin analitik të projektakteve të planifikuara për Ministrinë e Drejtësisë, për vitin 2019, miratuar me vendimin nr.764, datë 27.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2019”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Realizimi i misionit dhe vizionit të sistemit të zbatimit të vendimeve penale me burgim, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale, mbështetet para së gjithash në integritetin, gatishmërinë, motivimin dhe kapacitetet profesionale të stafit.

Stafi i shërbimit të burgjeve dhe paraburgimeve përbëhet nga punonjës me uniformë, të cilët përbëjnë efektivin e Policisë së Burgjeve, që rekrutohet dhe funksionon në bazë të ligjit “Për Policinë e Burgjeve”, i cili është miratuar fillimisht në prill 1998 dhe më pas është ndryshuar në vitet 2008 dhe 2014.

Me gjithë ndryshimet e deritanishme nuk është përmirësuar zhvillimi i karrierës së punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe promovimi i tyre në detyrë, ç’ka ka sjellë si pasojë faktin që trajtimi ekonomik e financiar të mbesë në nivele të ulëta në krahasim me agjencitë e tjera të përafërta. Në këtë kontekst, trajtimi i punonjësve të policisë të rolit të mesëm nuk është i përshtatshëm në lidhje me kërkesat për përmbushjen e detyrave. Kapacitetet profesionale dhe fizike të disa shërbimeve, veçanërisht operacionale, janë të ulëta dhe kanë nevojë për përtëritje. Po kështu, përmirësimi i teknologjisë kërkon një staf më të kualifikuar, me qëllim garantimin e sigurisë.

Krahas rezultateve pozitive, në garantimin e sigurisë dhe rehabilitimin e personave në konflikt me ligjin, që ka arritur sistemi shqiptar i burgjeve dhe paraburgimeve, vlerësohet se ka disa problematika të cilat duhen përmirësuar duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Evropian).

Problematikat lidhen së pari me nivelin jo të kënaqshëm të performancës së punonjësve të Policisë së Burgjeve, që lidhet me rekrutimin, trajtimin ekonomik e financiar, kualifikimin, promovimin dhe mbështetjen e tyre. Menaxhimi i

deritanishëm nuk garanton një balancë, ndërmjet kërkesave për përmirësimin e shërbimit publik dhe respektimit të të drejtave të punonjësve. Kërkesat për garantimin e sigurisë publike dhe pritshmëritë e publikut janë të mëdha. Vendi ynë ka 24 institucione të zbatimit të vendimeve penale, të shpërndara nga veriu në jug dhe në disa raste shumë larg qendrave urbane, me kapacitete të ndryshme, në të cilat trajtohen persona me rrezikshmëri të lartë për komunitetin dhe rendin publik.

Procedurat aktuale dhe situata në të cilën ndodhen punonjësit e Policisë së Burgjeve ka sjellë vështirësi në rekrutimin e punonjësve cilësorë dhe prezencën e një numri të konsiderueshëm të punonjësve me moshë mbi 55 vjeç, gjë që sjell vështirësi në kryerjen e detyrave që kanë lodhje fizike. Numri i punonjësve të Policisë së Burgjeve mbi 50 vjeç është 24.7%.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji, ndaj edhe nisma e propozuar paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji ndonëse është përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021, të miratuar me vendimin nr.201, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së, për shkak se rekomandimet ReC (2006)² të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për rregullat evropiane në burgje”¹, të cilat kanë shërbyer si referim për hartimin e këtij projektligji, nuk kanë karakter detyrues, por shërbejnë si një instrument fleksibël i së drejtës komunitare për të përshtatur objektivat e politikave kombëtare në drejtim të politikave evropiane.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji ka në përmbajtje të tij dhjetë krerë, ku në kreun I përcaktohen dispozitat e përgjithshme, në kreun II përcaktohen parimet e organizimit dhe të funksionimit të Policisë së Burgjeve, në kreun III përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Policisë së Burgjeve, në kreun IV përcaktohet marrëdhënia e punës, pranimi dhe trajtimi i personelit të Policisë së Burgjeve, në kreun V përcaktohen

¹ Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 11 janar 2006, në takimin e 952-të të zëvendësministrave)

rregullat për transferimin dhe komandimin, në kreun VI përcaktohet klasifikimi i pozicioneve në Policinë e Burgjeve, në kreun VII përcaktohen procedurat disiplinore, në kreun VIII përcaktohet përfundimi i marrëdhënies së punës, në kreun IX përcaktohet bashkëpunimi me subjektet e tjera dhe në kreun IX përcaktohen dispozitat e fundit.

Nenet 1-4 përcaktojnë qëllimin e ligjit, subjektet që e zbatojnë, përkufizimet dhe statusin e Policisë së Burgjeve.

Nenet 5-10 përcaktojnë parime të rëndësishme që udhëheqin veprimtarinë e Policisë së Burgjeve. Këto parime janë sanksionuar në projektligj për të theksuar rëndësinë e këtij funksioni me profesionalizëm dhe në respektim të plotë të misionit të Policisë së Burgjeve dhe të trajtimit me dinjitet të personave me kufizim lirie.

Neni 11 përcakton organizimin strukturor të Policisë së Burgjeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.90/2012, “Për organizimin e administratës shtetërore”, si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, institucion varësie e Ministrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, ky nen parashikon për herë të parë krijimin e strukturës së posaçme të Policisë së Burgjeve, e cila funksionon si pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së Policisë së Burgjeve dhe ushtron funksionet përkatëse për garantimin e ruajtjes së rendit e të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, si dhe mbrojtjes së posaçme të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesve të IEVP-ve.

Neni 12 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë së Burgjeve, për garantimin e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe në institucionet ku shoqërohen apo transferohen të dënuarit me burgim dhe të paraburgosurit, si dhe garantimin e sigurisë fizike gjatë shoqërimit apo transferimeve. Ky nen ngarkon Policinë e Burgjeve me marrjen e masave për sigurinë për zhvillimin e veprimtarive të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, si edhe për sigurimin e jetës e të shëndetit të personave të paraburgosur e të dënuar, si dhe të garantimit të rendit e të sigurisë së institucionit, në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

Nga ana tjetër, ky nen përcakton edhe detyrimin e Policisë së Burgjeve për ruajtjen fizike të ambienteve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, në rastet dhe në përputhje me urdhrin e nxjerrë nga ministri i Drejtësisë.

Po kështu, neni përkatës përcakton në mënyrë të veçantë edhe funksionet e strukturës së posaçme të Policisë së Burgjeve.

Neni 13 përcakton të drejtën për të mbajtur armë dhe pajisje kufizuese, sipas rasteve e kriterëve që përcakton projektligji dhe legjislacioni në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit. Pajisje kufizuese janë pajisjet që përdor Policia e Burgjeve në situata të veçanta, me qëllim garantimin e rendit e të sigurisë, si dhe sigurisë fizike në regjimin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe në rastet e parandalimit të një arratisjeje të mundshme. Ky nen garanton trajtimin human dhe njerëzor nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve, të personave të dënuar dhe të paraburgosur, duke ndaluar përdorimin e zinxhirëve dhe të hekurave.

Ky nen, gjithashtu, parashikon se edhe kur duhet të përdoren armë apo pajisje kufizuese, punonjësi i Policisë së Burgjeve duhet të ketë përfunduar trajnimet përkatëse për përdorimin e tyre.

Sa i takon përdorimit të armëve ndaj kategorisë të të miturve, do të zbatohen dispozitat Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ndërsa rregulla të hollësishme për përcaktimin e rasteve dhe mënyrës së përdorimit të armëve, të ndryshme nga ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit, si dhe pajisjeve kufizuese do të miratohen me vendim të Këshilli i Ministrave.

Neni 14 përcakton se përdorimi i forcës ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve mund të lejohet vetëm si një mjet i fundit kur lind e nevojshme nga situata të vetëmbrojtjes ndalimi i akteve të dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, ose të rezistencës aktive apo pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Në këto raste, forca nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

Forca duhet të përdoret në minimumin e mundshëm dhe në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të trajtimit çnjerëzor ose degradues. Për këtë qëllim, projektligji parashikon se personeli, që merret drejtpërdrejt me të burgosurit, trajnohet për teknikat, që e bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës për të kthyer vetëkontrollin te të burgosurit agresivë. Ndërkohë, rregulla të hollësishme për mënyrat, teknikat dhe masat e përdorimit të forcës, do të përcaktohen në mënyrë më të detajuar nga rregullorja e përgjithshme e burgjeve.

Sa i takon situatave kur mund të cenohet siguria dhe veprimtaria në sistemin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, Policia e Burgjeve bashkëpunon me strukturat e tjera, që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë. Kur punonjësit e strukturave që veprojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë hyjnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të trajtuar konflikte, nga strukturat përkatëse zbatohet marrëveshja e lidhur ndërmjet ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Brendshëm. Në marrëveshje parashikohen kushtet dhe masa e të drejtave, që kanë punonjësit e secilës strukturë, llojet e ndryshme të forcës, rrethanat kur përdoret çdolloj force, niveli i nevojshëm i kompetencave përpara se të përdoret forca dhe raportet, që duhet të përgatiten pas përdorimit të forcës. Ky parashikim është i nevojshëm për të përcaktuar

ndarjen e detyrave, të drejtat që kanë këta punonjës gjatë ndërhyrjes, llojin e forcës që përdoret, urdhërimet e përdorimit të forcës dhe raportet përkatëse pas përdorimit të saj.

Neni 15 përcakton ushtrimin e kontrollit në mjedise dhe ndaj subjekteve që vuajnë si rezultat i një vendimi gjykatë, personave që hyjnë në regjim me statusin e vizitorit, si dhe personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Njëkohësisht ky nen parashikon edhe rregullimet përkatëse për kategoritë e ndryshme dhe ndalimin për të ushtruar kontroll intim nga personeli i burgjeve. Për pasojë, kontrolli intim për personat e dënuar dhe të paraburgosur do të bëhet vetëm nga mjeku i burgut, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 16 parashikon kalimin në gatishmëri të Policisë Burgjeve, në rastet kur, të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim kufizohen ose hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

Kalimi në gatishmëri bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të përcaktojë masat që i përgjigjen nivelit të sigurisë në institucion, si dhe nivelin e klasifikimit të gatishmërisë, në përputhje me vlerësimin e rrezikut të situatave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve. Për raste të veçanta, kur nevoja dhe urgjenca janë të tilla që kërkojnë marrjen e masave të menjëhershme, kalimin në gatishmëri e bën drejtori i Policisë së Burgjeve ose zëvendësi i tij, me miratimin e ministrit të Drejtësisë brenda 24 orëve.

Neni 17 parashikon trajtimin ekonomik dhe financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve, duke iu referuar trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit. Për këtë qëllim, punonjësit të Policisë së Burgjeve i njihet e drejta për trajtimin ekonomik dhe financiar, ku përfshihen:

- a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune;
- b) kompensimi për kostot shtesë për largësi nga vendbanimi, pagesat për transport apo qiraja e banesës, në rast pamundësie të garantimit të transportit në vendin e punës nga vetë institucioni.

Ndërsa procedurat që do të ndiqen për trajtimin gjatë qëndrimit në punë do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Krahas rregullimeve të këtij projektligji dhe për ato çështje që nuk janë përcaktuar shprehimisht në këtë projektligj, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së

Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 18 parashikon trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, ndërsa neni 19 përcakton rregullime specifike për mbrojtjen e veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP-ve.

Neni 20 parashikon kujdesin ndaj grave shtatzëna gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 21 parashikon të drejtën për kohën e pushimit javor, vjetor dhe pushimeve të tjera të paguara. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjësit e rolit madhor dhe të lartë është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, për rolin e mesëm 40 (dyzet) ditë kalendarike, ndërsa për punonjësit e rolit bazë dhe punonjësit në cilësinë e aspirantit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

Ky nen përcakton edhe raste të tjera kur punonjësi përfiton pushime të paguara si për rastet e martesës, lindjes së fëmijës, sëmundjes së rëndë ose vdekjes së bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijës, prindërve, vëllezërve dhe motrave, pësimit të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, ndërrimit të banesës, ndërrimit të vendbanimit të përhershëm për shkak të detyrës, përgatitjes dhe mbrojtjes së titujve pasuniversitarë për punën që kryejnë.

Gjithashtu, për raste të veçanta, punonjësi ka të drejtë të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar.

Në nenet 22 dhe 23 janë të parashikuara të drejtat civile dhe politike të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Nenet 24 dhe 25 parashikojnë për ndalimin e grevës dhe kufizimin e së drejtës së lëvizjes për arsye se ndërprerja e punës në këtë sektor rrezikon sigurinë e shëndetit dhe rrezikon respektimin e të drejtave e lirive të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Neni 26 parashikon detyrimin për të qenë i përgjegjshëm dhe njëkohësisht të drejtën për të refuzuar zbatimin e një urdhri të paligjshëm.

Neni 27 parashikon detyrimin e punonjësit të Policisë së Burgjeve për të përdorur uniformën, shenjat dhe simbolet e Policisë së Burgjeve vetëm gjatë kryerjes së detyrës dhe në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

Neni 28 sanksionon një parim shumë të rëndësishëm, atë të shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Ky parim është sanksionuar që në fillim të kreut IV, pasi të gjithë punonjësit aktualë dhe në të

ardhmen do të gëzojnë të drejtën e zhvillimit të karrierës mbi baza merite dhe aftësive profesionale.

Neni 29 përcakton kriteret e përgjithshme të hyrjes në profesion, që do të duhet t'i përmbushin të gjithë personat që aspirojnë të punojnë pranë Policisë së Burgjeve. Projektligji përcakton edhe balancimin e raportit ndërmjet burrave dhe grave, duke krijuar një standard të ri në sistemin e burgjeve.

Neni 30 parashikon trajnimin bazë të kandidatëve të shpallur fitues për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve, periudhën e provës, trajnimin vazhdues dhe sistemin vjetor të vlerësimit të performancës në punë. Këto mekanizma janë përzgjedhur për të rritur nivelin e ofrimit të shërbimit të ofruar nga punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Nenet 31-33 përcaktojnë autoritetet dhe kriteret e emërimit për punonjësit e Policisë së Burgjeve, sipas roleve të tyre.

Nenet 34 e 35 përcaktojnë rregullat për transferimin dhe komandimin. Në projektligj parashikohet se transferimi mund të bëhet me pëlqim të punonjësit vetëm për nevoja dhe në interes të punës, duke shmangur kështu edhe transferimet abuzive. Për punonjësit e rolit bazë, transferimi lejohet deri në 45 kilometra larg vendbanimit. Në rast ankese, punonjësit i lind e drejta për t'u ankuar në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe, në çdo rast, afati i organit kompetent për t'u shprehur mbi ankimin, nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë. Ndërsa komandimi parashikohet në rastet e mbarëvajtjes ose për përballimin e mbingarkesës së punës në sistemin e burgjeve. Periudha e komandimit nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj. Gjatë kohës së komandimit punonjësit i ruhet vendi i punës ku merr edhe pagën. Kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk i sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, punonjësi i komanduar trajtohet sipas trajtimit financiar të parashikuar nga neni 17 i këtij projektligji.

Neni 36 parashikon klasifikimin e pozicioneve në Policinë e Burgjeve sipas roleve, gradave, si dhe natyrës së pozicionit përkatës. Klasifikimi bazohet në përshkrimin e punës të çdo pozicioni.

Neni 37 parashikon rolet që reflektojnë nivelin e organizimit, të drejtimit, të kontrollit dhe të zbatimit të detyrave. Rolet ndahen në këto kategori:

- a) Roli i lartë;
- c) Roli i mesëm;
- ç) Roli bazë.

Nenet 38 dhe 39 përcaktojnë gradat në Policinë e Burgjeve sipas roleve dhe hierarkisë së roleve dhe gradave.

Nenet 40 - 42 përcaktojnë rregullime të rëndësishme për marrjen e gradës apo të ecurisë në karrierë për punonjësit, që nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas funksioneve korresponduese për çdo gradë. Gjithashtu, parashikohen edhe autoritetet përkatëse për dhënien e gradave sipas roleve. Dhënia e gradave është një proces që i nënshtrohet një vlerësimi nga komisioni i dhënies së gradave, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohet nga autoriteti që parashikon projektligji për dhënien e tyre sipas roleve (respektivisht nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe nga ministri i Drejtësisë).

Neni 43 parashikon përcaktimin e gradave në funksion.

Neni 44 parashikon se paraqitja, forma dhe ndërtimi gradave do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45 parashikon të drejtën e ankimit lidhur me ecurinë në gradë, si edhe autoritetet përkatëse të shqyrtimit të ankimit sipas roleve, duke iu referuar procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 46 parashikon llojet e masave disiplinore dhe kushtet për dhënien e tyre, ndërsa rregulla të detajuara për kategoritë, llojet e shkeljeve, procedurat për dhënien e masave disiplinore, autoritetin kompetent për dhënien e tyre, si dhe përbërja, organizimi dhe funksionimi i komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve do të përcaktohen në rregulloren e disiplinës.

Neni 47 garanton të drejtën e punonjësit që për çdo shkelje të jepet vetëm një masë disiplinore. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Neni 48 përcakton autoritetet për dhënien e masave disiplinore.

Neni 49 parashikon rregullime specifike lidhur me ankimin ndaj masës së dhënë, afatin dhe autoritetin ku do të duhet të paraqitet ankimi.

Neni 50 parashikon krijimin dhe funksionin e komisionit të apelimit të masave disiplinore pranë Ministrisë së Drejtësisë, si edhe kompetencën e tij për të lënë në fuqi masën disiplinore, kur e gjen të bazuar, ta shfuqizojë atë ose të kërkojë rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën.

Neni 51 i projektligjit parashikon afate specifike të shuarjes së masës disiplinore, ndërkohë që për largimin nga detyra, masa qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit të Policisë së Burgjeve.

Në nenin 52 parashikohet rasti i pezullimit nga detyra të punonjësit të Policisë së Burgjeve, me fillimin e një procedimi penal deri në përfundim të procesit penal me vendim të formës së prerë. Gjatë kësaj periudhe është parashikuar që

punonjësi të përfitojë vetëm 50% të pagës. Gjithashtu, ky nen parashikon se në rastet kur pafajësia rezulton e provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, punonjësi i Policisë së Burgjeve rikthehet në punë dhe kompensohet për pjesën e mbetur të pagës që duhej të përfitonte gjatë periudhës së pezullimit.

Neni 53 parashikon rastet e lirimit nga detyra e punonjësit, të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe autoritetet respektive që bëjnë lirimin e këtyre subjekteve. Thëksojmë që edhe pse punonjësi lirohet nga detyra, atij i lind e drejta për t'u rikthyer, nëse përmbush kërkesat e përcaktuara në projektligj.

Neni 54 parashikon largimin nga detyra nëse punonjësi dënohet me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largimit nga Policia e Burgjeve.

Neni 55 parashikon rregulla specifike për sa i takon punonjësit të Policisë së Burgjeve, kur lirohet nga detyra dhe trajtimit financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, sipas rasteve të përcaktuara në ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 56 parashikon që punonjësit e Policisë së Burgjeve, që gjenden në pagesë kalimtare dhe që plotësojnë kushtet e kriteret për të vazhduar karrierën policore, nëse janë liruar nga detyra për shkak të riorganizimit, në çdo rast kanë përparësi për t'u rikthyer në shërbim. Përparësi kanë dhe ata punonjës që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura.

Neni 57 parashikon detyrimin që ka Policia e Burgjeve për të informuar publikun, lidhur me kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe sigurisë publike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Megjithatë, ky nen parashikon edhe për ndalimet që kanë të bëjnë me komunikimet në mënyrë joetike apo kur cenohen parime kushtetuese, si: prezumimi i pafajësisë, mosdiskriminimi, respektimi i dinjitetit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, veçanërisht të të miturve apo edhe ndalimi për t'u prononcuar në mënyrë individuale për çështje të cilat kanë të bëjnë me detyrën.

Neni 58 parashikon detyrimin e Policisë së Burgjeve për të bashkëpunuar me institucionet e administratës shtetërore dhe personat juridikë.

Neni 59 parashikon momentin e hyrjes në fuqi të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 17, të projektligjit, si dhe përcakton se aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr.10032, datë 11.12.2008, "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar, do të qëndrojnë në fuqi dhe do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij projektligji.

Neni 60 përcakton afatet e nxjerrjes së akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të projektligjit.

Neni 61 shfuqizon ligjin nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar.

Neni 62 parashikon se projektligji do të hyjë në fuqi në datën 1 janar 2020.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale dhe ministria përgjegjëse për punët e brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektligji kanë kontribuar anëtarët e grupit të punës, ngritur me urdhrin nr.4613, datë 24.4.2018, të ministrit të Drejtësisë, “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2018, propozuar nga ministri i Drejtësisë”, në përbërje të të cilit ka përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Gjithashtu, në procesin e hartimit të projektligjit kanë asistuar edhe ekspertë të jashtëm me njohuri të specializuara në fushën e sistemit penitenciar, të caktuar nga ambasada britanike. Projektligji i është nënshtruar paraprakisht edhe një procesi të gjerë konsultimesh me grupet e interesit dhe palët e tjera të interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore të përlllogaritura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e projektligjit janë pasqyruar në tabelën e pasqyruar në këtë relacion dhe do të përfshihen në programin buxhetor afatmesëm 2020-2022.

KOSTOT TOTALE TE PROJEKTILIGJIT TE POLICISE SE BURGJEVE									
	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
	Fondet e nevojshme	Planifikuar sipas tavanit ne PBA 2020-2022	Kerkesa shtese per pagen e grades	Fondet e nevojshme	Planifikuar ne PBA 2020-2022	Kerkesa shtese per vjetersine	Fondet e nevojshme	Planifikuar ne PBA 2020-2022	Kerkesa shtese per kushte pune
Paga dhe Kontribute per sigurime shogerore (600-601)	3,432,801,097	3,296,278,689	136,522,408	3,345,432,229	3,296,278,689	49,153,540	3,416,253,237	3,296,278,689	119,974,548
Mallra dhe sherbime (602-606)	219,140,080	219,140,080	-	219,140,080	219,140,080	-	219,140,080	219,140,080	-
Totali	3,651,941,177	3,515,418,769	136,522,408	3,564,572,309	3,515,418,769	49,153,540	3,635,393,317	3,515,418,769	119,974,548

Efektet financiare shitesë të këtij projektligji llogariten në total rreth 305.6 milionë lekë të cilat konsistojnë në: pagën e gradës rreth 136.5 milionë lekë, shitesën për vjetërsi rreth 49.1 milionë lekë dhe shitesën për kushte pune rreth 119,9 milionë lekë. Këto efekte shitesë do të shtrihen në të tria vitet e PBA-së 2020-2022, sipas përcaktimeve të nenit 59, të projektligjit, sipas planifikimit vijues:

- a) Rritja e pagës për gradë do të fillojë me hyrjen në fuqi të ligjit;
- b) Shtesa për vjetërsi pune do të fillojë efektet më 1 janar 2021;
- c) Shtesa për natyrë të veçantë pune do të fillojë efektet më 1 janar 2022.

KËSHILLI I MINISTRIVE